

VENDIM
Nr. 27, datë 16.2.2023

MBI ÇMIMIN E APLIKUESHËM TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI, ME HYRJEN NË FUQI TË VKM-së NR. 67, DATË 8.2.2023

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 10 të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi’, të ndryshuar”; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 736/2 prot., datë 14.2.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2023, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 67, datë 8.2.2023”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 327, datë 14.12.2022, vendosi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, prej 8.5652 lekësh/kwh për vitin 2023.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me VKM-në nr. 67, datë 8.2.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi’, të ndryshuar”, Këshilli i Ministrave vendosi që niveli maksimal i çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike, në çdo rast nuk do të jetë më i lartë se çmimi 10 lekë/kwh (pa TVSH).

- Në zbatim të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, formula e llogaritjes së çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi është:

Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kwh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kwh X Bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.20 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit

- Në vijim të ndryshimit të miratuar me VKM-në nr. 67, datë 8.2.2023, çmimi rezultues është mbi nivelin maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në germën “d” të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, prej 10 lekësh/kwh.

- Në VKM-në nr. 67/2023 është përcaktuar hyrja në fuqi e tij, pas botimit në Fletoren Zyrtare. Rezulton që ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 21, datë 9.2.2023.

- Në mbledhje mori pjesë dhe përfaqësuesi i AREA-s, i cili kërkoi që ndryshimet në VKM-në nr. 67, datë 8.2.2023, të aplikohen që nga data 1 janar 2023, si dhe nëse nuk aplikohen nga ky muaj u kërkua nga ERE t’i kompensojë kostot shtesë të shkaktuara, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Nga ERE iu shpjegua se ligji nr. 43/2015, në nenin 47, pika 8, shpjegon se si mund të kryhet kompensimi i kostove shtesë të shkaktuara për kryerjen e shërbimit publik, pas evidentimit të tyre.

- ERE, me anë të postës elektronike, më datë 10.2.2023, ka njoftuar OSSH sh.a. dhe OST sh.a., për dijeni dhe FTL sh.a., për hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023, duke i kërkuar

operatorëve të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e VKM-së dhe leximin e menjëhershëm të aparateve matës të energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi, me qëllim reflektimin e saktë të sasisë së energjisë elektrike të prodhuar gjatë muajit shkurt 2023, deri në momentin e hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 67/2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, prej 10 lekësh/kwh.

2. Efektet financiare të këtij çmimi fillojnë nga data 9.2.2023, me publikimin në Fletoren Zyrtare të VKM-së nr. 67/2023 e deri më 31.12.2023.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi i Bordit të ERE-s nr. 327, datë 14.12.2022, "Mbi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2023", shfuqizohet.

4. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti